

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM

KRITERET PËR KANDIDIM NË ORGANET DREJTUESE QSA

Kriteret për anëtarët e senatit akademik

1. Kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në institucionet publike të arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të kandidatëve me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.
3. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të ciklit të dytë, programeve profesionale të larta dhe programeve të studimeve specializuese afatgjata. Në rastet kur një student i zgjedhur në senatin akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Senatit Akademik, anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë apo studentët që:
 - a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
 - b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
 - d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

Kriteret për kandidatët për drejtor të QSA-së

1. Kandidatët për drejtor të QSA-së, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për drejtor të QSA-së duhet të mbajnë titullin "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose jashtë tij.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtor të QSA-së kandidatët që:
 - a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
 - b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
- d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.
- e) Kanë qenë drejtorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllongariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes.
- f) Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015.
- g) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Kriteret për drejtues të instituteve të QSA-së

1. Kandidatët për drejtues të instituteve të QSA-së duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për drejtues të instituteve të QSA-së i përkasin kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose jashtë tij.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë kandidatët që:
 - a. Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
 - b. Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. Janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - d. Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore;
 - e. Kanë qenë drejtues të instituteve, të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion, ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllongariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje-pavarësisht kohëzgjatjes;
 - f. Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015;
 - g. Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Kriteret për drejtues të departamenteve të instituteve të QSA-së

Kandidatët për drejtues të departamenteve të instituteve të QSA-së duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin të lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

1. Kandidatët për drejtues të departamenteve të instituteve të QSA-së janë personel akademik me kohë të plotë të departamentit, që i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor".
2. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të departamenteve të instituteve kandidatët që:
 - a. Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;

- b. Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c. Janë të dënuar më parë për vepra penale;
- d. Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.
- e. Kanë qenë drejtues të departamentit të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje-pavarësisht kohëzgjatjes.
- f. Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015.
- g. Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

KRYETARI

Sali Kadria



SEKRETARE

Sabina Dhrimo